VENDIM
Nr. 637, datë 26.10.2018

PËR DHËNIEN NË PËRDORIM, PA SHPËRBLIM, NGA DREJTORIA E SHËRBIMEVE QEVERITARE TE FONDI SHQIPTAR PËR ZHVILLIMIN E DIASPORËS DHE QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN, TË VILAVE NR. 5, NR. 6 DHE TË PALESTRËS SË BLLOKUT TË VILAVE GJERMANE, TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 901 e në vijim, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 4, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien në përdorim, pa shpërblim, nga Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare te Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, të vilës nr. 5, me oborret përkatëse, të bllokut të Vilave Gjermane, Tiranë dhe te Qendra e Botimeve për Diasporën të vilës nr. 6 dhe të objektit ndërmjet (palestra) me oborret përkatëse, të këtij blloku, për një afat të pacaktuar, me qëllim shfrytëzimin e tyre si mjedise pune për ushtrimin e veprimtarisë administrative.

2. Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës dhe Qendrës së Botimeve për Diasporën u ndalohet të ndryshojnë destinacionin e pronave të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, t'i tjetërsojnë ato ose t'ua japin në përdorim të tretëve.

3. Shpenzimet operative u ngarkohen Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës dhe Qendrës së Botimeve për Diasporën. Të drejtat dhe detyrimet e tjera do të përcaktohen në kontratën e huapërdorjes që do të lidhet ndërmjet palëve, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

4. Ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës dhe Qendra e Botimeve për Diasporën për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama